

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vodhën me dhunë xhiron ditore në dy pika karburanti/ Shpallet në kërkim 32-vjeçari, vijon puna për identifikimin e një tjetri
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/vodhen-me-dhune-xhiron-ditore-ne-dy-pika-karburanti-s-hpallet-ne-kerkim-3-i586664
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:10:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:40:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d4abeff04364085fe27f5d07d9759ec4852baa1da69607855c97b9cbb5478097
TEKSTI	a0c2cab9c8f0259b9f6b871380749d1dd7e12b6d43471b43b20c699019aea722
PAMJA	d27b65c282de704f213e02652f240fdc56415a6ca521d385ce7be6c75869e12

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02a6a515025212efe93cf173b3fd3225d50dcad861f63e5afb8bffa1d4a445cb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02a6a515025212efe93cf173b3fd3225d50dcad861f63e5afb8bffa1d4a445cb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Brazil, presidenti Lula i ben apel Ancelottit. Merr me shume futbolliste qe luajne ne kampionatin tone](#)U arsye perse Kosova arriti ketuKryeministri kanadez mban tjalim fundit

Vodhën me dhunë xhiron ditore në dy pika karburanti/ Shpallet në kërkim 32-vjeçari, vijon puna për identifikimin e një tjetri



17 Shtator 2026, 13:40Kronika TEMA



Policia ka identifikuar dhe shpallur në kërkim një 32-vjeçar, ndërsa vijojnë hetimet për identifikimin e autorit të dytë. N

ë kuadër të hetimeve janë sekuestruar edhe një automjet tip "Toyota" dhe një motomjet, të dyshuar se janë përdorur gjatë grabitjes.

Vodhën me dhunë xhiron ditore në dy pika karburanti, identifikohet dhe shpallet në kërkim njëri prej autorëve, vijon puna për identifikimin e autorit tjetër.

Sekuestrohen një automjet tip "Toyota" dhe një motomjet, të dyshuar se janë përdorur gjatë ngjarjes.

Ndërkohë, vijojnë kërkimet për lokalizimin dhe kapjen e autorit të shpallur në kërkim.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë, në bashkëpunim me strukturat e DVP Dibër, organizuan punën dhe kryen veprime të shpejta hetimore, duke bërë të mundur identifikimin e njërit prej autorëve të dyshuar.

Si rezultat, u shpall në kërkim shtetasi A. H., 32 vjeç, banues në Bulqizë, i cili dyshohet se, në bashkëpunim me një person tjetër ende të pidentifikuar, rreth orës 00:54, ka shkuar në dy pika karburanti, në Bulqizë dhe Fushë-Bulqizë, ku u kanë vjedhur me dhunë punonjësve të këtyre pikave xhiron ditore (18.300 dhe 38.600 lekë).

Në vijim të veprimeve dhe kontrolleve të kryera në zonë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan automjetin tip "Toyota", pa targa, si dhe një motomjet, të dyshuar se janë përdorur nga autorët gjatë kryerjes së vjedhjeve.

Vijon puna për kapjen e shtetasit të shpallur në kërkim dhe identifikimin e personit tjetër të përfshirë në ngjarje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"S'ka celular, merrni laptop" / GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatoheni, ose ndiqni rrugët ligjore!

12:30 Kronika / 1 koment

Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona

11:30 Kronika

"Nuk më janë vënë në dispozicion të gjitha fashikujt" - Shtyhet gjyqi i themelit për Ilir Metën, ja kur do të mbahet seanca e radhës

11:00 Kronika

VIDEO/Transportonte me makinën "Porsche" 13 lingota floriri kontrabandë, arrestohet 30-vjeçari

10:40 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.